



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës / Presednik Opštine / Municipal Mayor

KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES/KABINET PRESDEDIKA OPSTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 68 / Nr. ifaq/Br.str./No pg 233
Data/Datum/Date 27/21
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 8 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, nenit 21 paragrafi 3 pika 3.1 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil Nr. 03/L-147 i datës 13.05.2010, nenit 11 paragrafi 6 pika 6.1 të Rregullores Nr. 33/2012 për shtesat në paga dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin zyrtarit përgjegjës për koordinimin e konsultimeve, dëgjimeve dhe takimeve publike në Komunën e Rahovecit

1. **znj. Blerta Gashi**, e sistemuar në punë dhe detyrat e punës si: Zyrtare për Lektorim, pranë Zyrës së Kryetarit të Komunës, **CAKTOHET**:
 - 1.1. Zyrtare përgjegjëse për koordinimin e konsultimeve, dëgjimeve dhe takimeve publike në Komunën e Rahovecit.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit përgjegjës për koordinimin e konsultimeve, dëgjimeve dhe takimeve publike në komunën e Rahovecit sipas nenit 9 të UA (MAPL) Nr. 06/2018 janë: Përgatitja e formularëve shpjegues të projekt-propozimit për konsultim publik dhe dokumentacionit përcjellës; Koordinimin e konsultimit publik në bashkëpunim me zyrtarin përgjegjës për përgatitjen e draftit fillestar të projekt-propozimit dhe grupin punues; Përcjelljen e afateve kohore për procesin e konsultimit publik; Përgatitjen e njoftimit lidhur me formën e konsultimeve; Koordinon organizimin e takimeve të drejtpërdrejta me qytetarët dhe palët e interesuara; Mbledhjen e komenteve dhe rekomandimeve nga konsultime, dëgjime dhe takime publike përmes ueb-faqes së komunës dhe Platformës së Konsultimit Publik të Qeverisë dhe dërgimin e tyre te zyrtari përgjegjës për përgatitjen e draftit fillestar të projekt-propozimit apo grupin punues si dhe përpilimin e procesverbaleve nga konsultimet, dëgjimet dhe takimet publike.
3. Obligohet Zyrtari përgjegjës për koordinimin e konsultimeve, dëgjimeve dhe takimeve publike në Komunën e Rahovecit që të përgatis raporte vjetore për procesin e konsultimeve, dëgjimeve dhe takimeve publike të organizuara në Komunën e Rahovecit si dhe të raporton te Kryetari i Komunës dhe në njësinë përgjegjëse për monitorim të komunave në MAPL.
4. Obligohet e lartpërmendura që të veproj duke u bazuar në Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna.

5. Zyrtari i caktuar përgjegjës sipas pikës 1 të këtij vendimi ka të drejtë kompensimi për punën shtesë jashtë orarit të punës dhe atë 30% të pagës bazë për orë të plotë për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës.
6. Mjetet për pagesën e punëve jashtë orarit të rregullt do të sigurohen nga kodi Paga dhe Mëditje.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

Duke marrë parasysh nevojën e caktimit të zyrtarit përgjegjës për koordinimin e konsultimeve, dëgjimeve dhe takimeve publike në Komunën e Rahovecit, siç parashihet në nenit 8 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, i cili do të jetë përgjegjës për përgatitjen e dokumentacionit, koordinimin dhe përcjelljen e konsultimeve, dëgjimeve dhe takimeve publike të organizuara nga ana e Komunës së Rahovecit.

Për këtë arsye zyrtari përgjegjës për koordinimin e konsultimeve, dëgjimeve dhe takimeve publike në Komunën e Rahovecit caktohet znj. Blerta Gashi.

Andaj, marrë parasysh se konsultimet, dëgjimet dhe takimet publike mbahen jashtë orarit të rregullt të punës, është e domosdoshme që të caktohet punë shtesë jashtë orarit të rregullt të punës për të lartpërmendurën sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

Andaj, nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- *znj. Blerta Gashi,*
- *MAPL,*
- *Kryesuesi i Kuvendit,*
- *Drejtorët e drejtorive,*
- *Arkivi.*

